

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: “BAJRAM HA. GASHI” B.I. & “Hysen Sopa” B.I. me adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	12.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **10.11.2020**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **“BAJRAM HA. GASHI” B.I. & “Hysen Sopa” B.I.** me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I MUZEUT NË KRUSHË TË MADHE**, me Numër të prokurimit: **623-20-5659-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-20-040-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **“BAJRAM HA. GASHI” B.I. & “Hysen Sopa” B.I.** me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I MUZEUT NË KRUSHË TË MADHE**, me Numër të prokurimit: **623-20-5659-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-20-040-5-2-1**, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, të datës: **05.11.2020**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **RENOVIMI I STACIONIT TË AUTOBUSËVE DHE VENDOSJA E KABINAVE**, me Numër të prokurimit: **623-20-3186-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-20-029-5-2-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: “BAJRAM HA. GASHI” B.I. & “Hysen Sopa” B.I. me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I MUZEUT NË KRUSHË TË MADHE**, me Numër të prokurimit: **623-20-5659-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-20-040-5-2-1**, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, të datës: **05.11.2020**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **05.11.2020**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR NR 1.

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje lidhur me **Nenin 1 i LPP-së – Qëllimi**.

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që ne se i Autoriteti Kontraktues e kemi respektuar plotësisht Neni 1 të LPP-së, po ashtu kemi respektuar Nenin 59 të LPP – së, paragrafi 4, ku thotë: *“Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*.

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret sipas Njoftimit për Kontrat dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT)

Ne si Autoritet Kontraktues kemi respektuar plotësisht **Nenin 7, paragrafi 1** të LPP-së se *“Autoriteti Kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*,

Andaj ky pretendim i juaj ankimor është i pabazuar.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR NR 2.

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje lidhur me **Nenin 7 i LPP-së – Barazia në Trajnim/Jo-Diskriminimi**.

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që ne se i Autoriteti Kontraktues, me datë: 05.11.2020, me formular: B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuari, jeni njoftuar nga Autoriteti Kontraktues duke cekur nuk e keni përmbushur Kërkesën me Nr. të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, *me arsyetim: Ju keni ofruar një dokument nga banka e cila deklaron se banka do ta shqyrton mundësinë për të dhënë kredinë e kërkuar e jo akses siç është kërkuar, për me tepër deklaron se nëse i përmbahet rregullave dhe kritereve të kërkuara nga banka, po ashtu ju keni ofruar një dokument i cili nuk i përmbush kërkesat e FDT-se, pasi që nuk është përcaktuar asnjë vlerë nga Banka, kure në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), është kërkuar në vlerë prej së paku: 50,000.00 € - Andaj oferta e juaj refuzohet si e papërgjegjshme, pasi që nuk e keni plotësuar kërkesën me Nr. 2 të Kapaciteti ekonomik dhe financiar.*

Ne si Autoritet Kontraktues, nuk kemi mundur të përdorim Nenin 72 të LPP – së sipas pretendimeve tuaja, pasi që **paragrafi 3 i Neni 72** thotë: *Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive*, pasi që nuk mund të kërkohej plotësimi i dokumentacioneve pas afatit të skadimit për dorëzimin e ofertave, ku ne kemi cekur se ne Letër nga Banka mungonë vlera, pasi që nuk është përcaktuar asnjë vlerë nga Banka, kure në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), është kërkuar në vlerë prej së paku: 50,000.00 €

Andaj ky pretendim i juaj ankimor është i pabazuar.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR NR 3.

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje lidhur me Nenin 7 i LPP-së – Barazia në Trajnim/Jo-Diskriminimi dhe Nenin 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve.

Pretendimet ankimor se Operatori Ekonomik i ka plotësuar Kërkesën me Nr. 3, e kërkuar në pikën 9.1 & 9.2 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 220,000.00 €.

- Ne rast koncersiumi lideri duhet të ketë te paktën: 60 % te projekteve te realizuara.

Dëshmia 3: Lista e projekteve te kryera në lëmin e punëve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca t ose Pranimet teknik për punë të kryera në lëmin e punëve të ngjashme.

Ju sqarojmë se edhe pas rishqyrtimit të dokumentacioneve lidhur me këtë kërkesë, ju si Operatorë Ekonomik, nuk e keni plotësuar këtë kërkesë konform dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Në ofertën e juaj të dorëzuar si Operatorë Ekonomik, Referencat ose Pranimet teknike të dorëzuar nuk janë në lëmin e punëve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, ku dhe me datë: 05.11.2020, me formular: B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuari, jeni njoftuar nga Autoriteti Kontraktues duke cekur: *Në Njoftim për Kontrat dhe Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe professional, është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e punëve të ngjashme DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca/t ose Pranimet teknik për punë të kryera në lëmin e punëve të ngjashme. Referenca/t ose Pranimet teknik për punë të kryera të dorëzuar nga ana juaj nuk janë në lëmin e punëve të ngjashme, Andaj oferta e juaj refuzohet si e papërgjegjshme, pasi qe nuk e keni plotësuar kërkesën me Nr. 3 të Kapaciteti teknik dhe professional.*

Andaj ky pretendim i juaj ankimor është i pabazuar.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit